



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:265332

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06207570

C.nr.1113/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, nëpërmjet gjyqtarit Selajdin Gallapeni, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike të paditësve ; S.K, SH.B, SH.T, SH.B-B, SH.G, SH.K, K.B, dhe I.SH, që të gjithë të punësuar në SH.F.M.U “Destan Bajraktari” në Suharekë, të cilët i përfaqëson i autorizuari B. K, avokat nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A. B, me objekt kontesti shpërblimin e inflacionit në pagë, me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve S.K, SH.B, SH.T, SH.B - B, SH.G, SH.K, dhe K.B, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria e Arsimit që në emër të diferencës së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit, përkatësisht prej periudhës 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, t’ua paguaj paditësve shumat si në vijim:

1. Paditësit S. K;

Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 970.89 euro;

2. Paditëses Sh. B;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 970.89 euro;

3. Paditëses Sh. T;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 970.89 euro;

4. Padi tëses Sh. B – B;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 970.89 euro;

5. Padi tëses Sh. G;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 970.89 euro;

6. Padi tëses Sh. K;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 658.81 euro;

7. Padi tëses K. B;

- Për periudhën prej 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, shumën e përgjithshme prej 838.54 euro;

Të gjitha këto në shuma me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë 04.12.2023 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Suharekës, që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë padi tësve shumën prej 333.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e padi tësit Islam Shala, me të cilën ka kërkuar që “ *të APROVOHET kërkesëpadia e padi tësit Islam Shala nga Suhareka dhe të DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë që padi tësit shumën e të hollave në emër të kompensimit të përqindjes të bazuar në shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe atë në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro*”, si e pabazuar.

Arsyetim

Padi tësit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komunës së Suharekës, Drejtoria e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në pagë nga shkalla e inflacionit për çdo vit sipas Entit të Statistikave të Kosovës.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, Komuna e Suharekës – Drejtoria e Arsimit pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigjen në padi, me të cilën ka theksuar se me qëllim që t'i ikim shpenzimeve të panevojshme të procedurës, i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta aprovoj pjesërisht si të bazuar në bazë të përqindjes zyrtare të inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, pa seancë dhe shqyrtim, ndërsa pjesën tjetër të e refuzoj si të parashkruar, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të punës, i cili thotë “ *Të gjitha kërkesat nga*

marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 ndërlidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëseve S.K, SH.B, SH.T, SH.B - B, SH.G, SH.K, dhe K.B, është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, i aprovoi kërkesëpaditë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa kërkesëpadia e paditësit I. Sh, pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes në padi e në kuptim të nenit 8 të ndërlidhur me nenin 399 të LPK-së, është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes të njëjtën e refuzoi si në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në nenin 7 par. 1 i Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se të dy paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Si fakt kontestues për të paditurën ishte vetëm çështja e parashkrimit të kërkesave.

Në bazë të nenit 398 të LPK-së, parashihet se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëseve, që t’ua kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit për vitin 2020 – 0.2% ,për vitin 2021 – 3.4% si dhe për vitin 2022 – 11.6% duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”.*

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtresa e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Faktin e pagës bazë për paditësit gjykata e vërtetoi nga lista e pagave e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Në bazë të nenit 399 të LPK-së “399.1 Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. 399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

Gjykata vendosi si në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku vendosi që pjesa e kërkesëpadsisë për paditësin Islam Shala periudhën 01.05.2017 deri me datë 30.06.2019, të refuzohet si e parashkruar për faktin se sipas Ligjit të Punës, nenit 87 theksohet se, citojmë: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Pra padia është parashtruar me datë 04.12.2023, ndërsa nëse kthehemi tre vite mbrapa i bie data 04.12.2020, pra kërkesat pas kësaj të fundit kanë arritur afatin e parashkrimit.

Në lidhje me kamatën ligjore gjykata vendosi konform nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë ku për pesë paditës vlera është 312.00 euro, taksa në padi në shumën 21 euro ne total shumën 333.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:265332, 25.09.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.